



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 603/3 prot.

Tiranë, më 25.4.2025

V E N D I M

Nr. 11, datë 25.4.2025

PËR
DISA SHTESA NË RREGULLOREN E BRENDSHME TË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 25.4.2025, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Të bëhen këto shtesa në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, të miratuar me vendimin nr. 1, datë 31.1.2017, i ndryshuar:
 - a) Në Aneksin 11, “Kriteret e përzgjedhjes së pedagogëve dhe trajnerëve/ekspertëve të Shkollës së Magjistraturës”, në pikën 3.2 “Përzgjedhja e pedagogëve dhe trajnerëve/ekspertëve”, shtohen paragrafët si vijojnë:

“Për përzgjedhjen e pedagogëve, trajnerëve/ekspertëve të SHM, thirrja për aplikime bëhet, së pari, për magjistratët në detyrë. Në rast se nuk ka aplikime nga magjistratët në detyrë, ose ato nuk përmbushin plotësisht vendet vakante, bëhet thirrje për aplikime sipas pikës “a” më sipër.

Magjistrati që është shkarkuar me vendim të KPK dhe/ose KPA, në procesin e rivlerësimit (vetting-ut), nuk mund të përzgjidhet në detyrën e pedagogut, trajnerit/ekspertit në Programet e Formimit Fillestar dhe atij Vazhdues të SHM.

Magjistrati që nuk i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, për shkak se ka dhënë dorëheqjen, sipas vendimeve të KPK dhe/ose KPA, nuk preferohet në procesin e përzgjedhjes për detyrën e pedagogut, trajnerit/ekspertit në Programet e SHM, edhe nëse është kandidat i vetëm.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 603/14 prot.

Tiranë, më 25.4.2025

V E N D I M

Nr. 12, datë 25.4.2025

P Ë R

MIRATIMIN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË TESTIT PROFESIONAL DHE
KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË TESTIT TË SHËNDETIT MENDOR DHE
PSIKOLOGJIK PËR PROVIMIN E PRANIMIT VITI AKADEMIK 2025-2026

Në mbështetje të nenit 248 dhe 266 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenit 31 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 25.4.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë komisionin e vlerësimit të testit profesional (faza e dytë) të provimit të pranimit për vitin akademik 2025-2026 me anëtarë:

- V. K. (kryetar) – Procedurë civile
- S. P. – E drejtë civile
- Y. P. – Procedurë penale dhe kazus penal
- N. P. – E drejtë penale dhe kazus penal
- V. Z. – E drejtë familjare
- A. D. – Kazus administrativ
- A. V. – Kazus Civil

2. Të miratojë komisionin e vlerësimit të testit të shëndetit mendor dhe psikologjik të provimit të pranimit për vitin akademik 2025-2026 me këtë përbërje:

1. Z. A. T. Kryetar (psikolog)
2. Znj. A. H. Anëtar (psikiatër)
3. Znj. A. P. Anëtar (psikiatër)

4. Znj. L. N. Anëtar (psikolog)
 5. Z. A. L. Pedagog i brendshëm (vëzhgues)
3. Të caktojë z. A. S., stacionier, për vlerësimin statistikor të testit me shkrim PSSI, të shëndetit mendor dhe psikologjik, në provimin e pranimit për vitin akademik 2025-2026.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.